



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 41, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031; nenit 9, paragrafëve 1 dhe 2; nenit 18, paragrafëve 1 dhe 3; neneve 24, 25, 26 dhe 27 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së nr. 275, datë 30.12.2024; si dhe nenit 12, paragrafi 7 të Rregullores mbi punën e organeve kolegjiale të OFK-së nr. 271, datë 30.12.2024, pas kalimit të afatit për paraqitjen e ankesave ndaj listës përfundimtare të publikuar më 30 prill 2026, si dhe pas shqyrtimit të kërkesave të pranuar për plotësim/ndryshim, në votimin qarkullues të datës **04.05.2026**, nxjerr këtë:

VENDIM

Për certifikimin e listave të anëtarëve me të drejtë vote në njësitë zgjedhore

- I. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Prishtinës**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 770.
- II. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Prizrenit**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 222.
- III. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Pejës**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 98.
- IV. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Gjilanit**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 116.
- V. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Gjakovës**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 97.
- VI. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Ferizajit**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 135.
- VII. Certifikohet lista e anëtarëve me të drejtë vote në **Njësinë Zgjedhore të Rajonit të Mitrovicës**, e cila fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin rendor 77.
- VIII. Listat e certifikuar bashkëngjiten si shtojcë e këtij vendimi dhe përbëjnë pjesë përbërëse të tij.
- IX. Udhëzohet Sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që verifikimin e aplikimeve për kandidim, si dhe të mbështetësve të tyre, ta bëjë në përputhje me listat e certifikuar sipas këtij vendimi.
- X. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

I dërgohet:

- Anëtarëve nga njësitë zgjedhore;
- Sekretariatit të KQZ-së.

pcv **Kryetari i KQZ-së**
Mr.Ph. Betim Ramadani